



Statistika e llogarive financiare – gjendje tremujore

Drejtoria e Statistikave
Departamenti i Statistikave të Llogarive Financiare
Prill, 2024




Analiza e llogarive financiare – gjendja në fund të tremujorit të katërt 2023, sipas sektorëve dhe instrumenteve



Mjetet dhe detyrimet financiare të ekonomisë nacionale

- **Pozita financiare negative neto** e ekonomisë vendase **në fund të vitit 2023 është 549 miliardë denarë**, që paraqet thellim prej 12,1 miliardë denarë në krahasim me tremujorin paraprak. Krahasuar me fundin e vitit 2022, NFP është thelluar për 26,8 miliardë denarë.
- Në terma të treguesve relativë, **pozicioni negative neto në tremujorin e katërt është 65.3% e PBB-së***, që paraqet një rritje prej 0.3 p.p, përkatësisht 1.4 p.p., në nivel vjetor dhe tremujor.

Totali i mjeteve financiare, detyrimet dhe vlera financiare neto - ekonomia nacionale (% e PBB-së)



* Të dhënat e PBB-së janë vjetore, burimi: Enti Shtetëror i Statistikave.


** Të dhënat për llogaritë financiare përmbajnë rishikime të të dhënave për tremujorin. 1 - sq. 3 të vitit 2023, si rezultat i rishikimit të PBB-së 2023 dhe rishikimeve në statistikatat parësore.



Mjetet dhe detyrimet financiare të ekonomisë nacionale

- Analizuar nga aspekti i sektorëve, amvisëritë dhe sektori "i huaj" janë kreditorë neto dhe financojnë pjesën tjetër të sektorëve në ekonominë nacionale (SHJF dhe shtetin), të cilët janë debitorë neto. Sektori financiar vijon të ketë një pozicion financiar neto pothuajse të balancuar.
- Në mënyrë dinamike, thellimi i VFN-së negative rezulton nga rritja e VFN-së negative të shtetit dhe shoqërive jofinanciare, në kushtet e një pozicioni të përmirësuar të amvisërisë.

Vlera financiare neto, sipas sektorëve (% e PBB-së)






Mjetet dhe detyrimet financiare të ekonomisë nacionale, sipas sektorëve

- Struktura e **mjeteve të ekonomisë nacionale** tregon se nuk ka ndryshime të rëndësishme, ku sektori SHJF dhe shoqëritë financiare kanë pjesëmarrjen më të madhe (pothuajse të barabartë), të ndjekur nga amvisëritë, si dhe shteti që ka pjesëmarrjen më të vogël në totalin e mjeteve të ekonomisë nacionale.
- Në strukturën e **totalit të detyrimeve** sipas sektorëve pjesëmarrje më të madhe kanë shoqëritë jofinanciare, të ndjekura nga shoqëritë financiare dhe shteti. Amvisëritë kanë pjesëmarrje më të vogël në totalin e detyrimeve të ekonomisë nacionale.

Mjetet financiare dhe detyrimet e ekonomisë nacionale - sipas sektorëve (në %)







Mjetet dhe detyrimet financiare të ekonomisë nacionale, sipas sektorëve

- Në fund të vitit 2023, **totali i mjeteve të ekonomisë nacionale** arrin në 3,790 miliardë denarë dhe kanë shënuar rritje tremujore prej 154,8 miliardë denarë, ose 4,3%. Në raport me tremujorin e fundit të vitit 2022, gjithsej mjetet e ekonomisë nacionale shënuan rritje prej 280 miliardë denarë ose 8%.
- Ndryshimi në rritje në nivel tremujor dhe vjetor është rezultat i rritjes së mjeteve në të gjithë sektorët dhe kryesisht në shoqëritë financiare dhe amvisëritë.

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas sektorëve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas sektorëve (miliardë denarë)







Mjetet dhe detyrimet financiare të ekonomisë nacionale, sipas sektorëve

- Në fund të vitit 2023, **totali i detyrimeve** arrin në 4,339 miliardë denarë dhe shënuan rritje tremujore prej 166,9 miliardë denarë ose 4%. Në krahasim me tremujorin e fundit të vitit paraprak, gjithsej detyrimet shënuan rritje prej 306,7 miliardë denarë.
- Kontributin më të madh në rritjen tremujore dhe vjetore e japin shoqëritë financiare dhe jofinanciare, me një kontribut më të vogël nga shteti dhe amvisëritë.

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas sektorëve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas sektorëve (miliardë denarë)






Mjetet dhe detyrimet financiare të ekonomisë nacionale, sipas instrumenteve

- Struktura e **instrumenteve nga ana e mjeteve** nuk shfaq ndryshime të rëndësishme në tremujorin e fundit. Instrumenti kapital vijon të ketë pjesëmarrje më të madhe, i ndjekur nga paratë e gatshme dhe depozitat, kërkesat e tjera, kreditë dhe LV. Ari monetar dhe SPV kanë pjesëmarrje më të vogël në strukturën e mjeteve.
- Instrumentet kapitale dhe kreditore janë më të përfaqësuara në strukturën e **totalit të detyrimeve**, të ndjekura nga paratë e gatshme dhe depozitat, detyrimet e tjera dhe instrumentet e tjera. Ashtu si nga ana e mjeteve, në tremujorin e fundit nuk janë vërejtur ndryshime të rëndësishme në strukturë.

Mjete financiare dhe detyrimet e ekonomisë nacionale - sipas instrumenteve (në %)







Mjetet dhe detyrimet financiare të ekonomisë nacionale, sipas instrumenteve

- Analizuar sipas instrumenteve, **nga ana e mjeteve**, rritje më të madhe tremujore është vërejtur te paratë e gatshme dhe depozitat (101,7 miliardë denarë) dhe kapitalit (49,1 miliardë denarë).
- Në raport me fundin e vitit 2022, është shënuar rritje prej 280 miliardë denarë, me rritje të mjeteve në të gjitha instrumentet, me përjashtim të kërkesave tjera. Kontributin më të madh në ndryshimin vjetor e kanë pasur paratë e gatshme dhe depozitat (128,5 miliardë denarë) dhe kapitali (95,3 miliardë denarë).

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)






Mjetet dhe detyrimet financiare të ekonomisë nacionale, sipas instrumenteve


- **Nga ana e detyrimeve**, rritje më të lartë tremujore është vërejtur te paratë e gatshme dhe depozita (67,7 miliardë denarë), kapitali (43,9 miliardë denarë) dhe kreditë (36,3 miliardë denarë).
- Në krahasim me **tremujorin e fundit të vitit 2022**, në rritjen prej 306,7 miliardë denarë, kontributin më të madh kanë kapitali (116,6 miliardë denarë), paratë e gatshme dhe depozitat (75,7 miliardë denarë), kreditë (59,4 miliardë denarë) dhe letrat me vlerë (46,7 miliardë denarë), me reduktim të detyrimeve të tjera (6,2 miliardë denarë).

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Detyrime të tjera
Derivatet financiare
Sigurimi, pensionet dhe skemat e standardizuara të garantuara
Kapitali dhe aksionet/pjesët e fondeve investuese
Kredite
Letrat me vlerë të borxhit
Para të gatshme dhe depozitat
Ari monetar dhe SPV
Totali i detyrimeve financiare

Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ari monetar dhe SPV
Para të gatshme dhe depozitat
Letrat me vlerë të borxhit
Kredite
Kapitali dhe aksionet/pjesët e fondeve investuese
Sigurimi, pensionet dhe skemat e standardizuara të garantuara
Derivatet financiare
Detyrime të tjera
Totali i detyrimeve financiare




ANALIZA E TË DHËNAVE TË LLOGARISË FINANCIARE SIPAS SEKTORËVE




Sektori i shoqërive jofinanciare (SHJF)

- **Vlera financiare neto** e sektorit SHJF në tremujorin e katërt të vitit 2023 është negative dhe arrin në 1043 miliardë denarë, që paraqet thellim tremujor prej 26,9 miliardë denarë ose 2,6%. Në nivel vjetor, vlera financiare neto negative është rritur për 62,1 miliardë denarë ose 6,3%.
- E analizuar nëpërmjet treguesve relativë, vlera financiare neto negative është 124% e PBB-së, që paraqet një rritje prej 3 p.p. krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Mjetet dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto e SHJF






Sektori i shoqërive jofinanciare (SHJF)

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- **Ndryshimi tremujor** i totalit të mjeteve është pozitiv dhe arrin në 21,3 miliardë denarë, ku pjesëmarrjen më të madhe në rritje e kanë kapitali dhe aksionet/pjesët e fondeve investuese (19 miliardë denarë), me pas vijnë paratë e gatshme dhe depozitat (12 miliardë denarë), me rënie të kredive prej 12,3 miliardë denarë.
- **Në krahasim me fundin e vitit 2022**, gjithsej mjetet janë rritur për 42,9 miliardë denarë, ku pjesëmarrjen më të madhe në rritje e kanë kapitali dhe aksionet/pjesët e fondeve investuese (31,5 miliardë denarë) dhe paratë e gatshme dhe depozitat (19,7 miliardë denarë), me rënie të kërkesave të tjera (13,9 miliardë denarë)




Sektori i shoqërive jofinanciare (SHJF)

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- **Ndryshimi tremujor** i totalit të detyrimeve është pozitiv dhe arrin në 48,2 miliardë denarë, kryesisht si rezultat i rritjes së kapitalit (29,6 miliardë denarë) dhe kredive (17,5 miliardë denarë)
- **Krahasuar me fundin e vitit 2022**, gjithsej detyrimet janë rritur për 105 miliardë denarë, me kontribut më të madh të kapitalit (81,9 miliardë denarë) dhe kredive (36,3 miliardë denarë), me rënie të detyrimet tjera (13,2 miliardë denarë).




Borxhi i Sektorit SHJF

- Borxhi* i SHJF-së në tremujorin e katërt të vitit 2023 arrin në 66,3% të PBB-së, që paraqet rritje në krahasim me tremujorin paraprak prej 17,5 miliardë denarë ose 2,1 p.p., kryesisht si rezultat i rritjes së huamarrjes nga ndërmarrjet nga jashtë. Në nivel vjetor, borxhi i SHJF-së shënoi rritje prej 36,3 miliardë denarë dhe është më i lartë për 1,4 p.p. nga PBB.
- Nga pikëpamja sektoriale, SHJF-të marrin hua pothuajse në mënyrë të barabartë nga sektori financiar (bankat) dhe nga jashtë, ndërsa një pjesë më e vogël llogaritet nga huamarrja ndëreshoqërore.

Borxhi i shoqërive jofinanciare



Struktura e borxhit të shoqërive jofinanciare, sipas sektorëve




**) Borxhi i NFD-së dhe sektorëve të tjerë në analizë përfshin instrumentet financiare: kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit*




Sektori i amvisërisë

- **Pozicioni pozitiv neto i amvisërive** në fund të vitit 2023 është 718,6 miliardë denarë, ose 85,5% e PBB-së. Në bazë tremujore është arritur rritje prej 40,5 miliardë denarë ose 6%. Pozicioni më i mirë pozitiv neto rezulton nga rritja më e madhe e mjeteve financiare (46,1 miliardë denarë) krahasuar me rritjen e detyrimeve (5,6 miliardë denarë). Në bazë vjetore, rritja e pozicionit neto të amvisërive arrin në 71,5 miliardë denarë, gjegjësisht 11,1%.

Mjete dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto e amvisërive






Sektori i amvisërisë

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Totali i mjeteve të amvisërive në tremujorin e katërt është rritur për 46,1 miliardë denarë ose 4,9%, **në bazë tremujore**. Shikuar sipas instrumenteve, rritja është kryesisht për shkak të rritjes së kapitalit dhe aksioneve/pjesëve të fondeve investuese (23,3 miliardë denarë), pastaj vijnë paratë e gatshme dhe depozitat (16,6 miliardë denarë).
- Krahasuar me **fundin e vitit 2022**, mjetet e amvisërive janë më të larta për 90,3 miliardë denarë, me kontributin më të madh të kapitalit dhe aksioneve/pjesëve të fondeve investuese (39,3 miliardë denarë), pastaj vijnë paratë e gatshme dhe depozitat (29,6 miliardë denarë) dhe kërkesat në bazë të sigurimeve (13,9 miliardë denarë).




Sektori i amvisërisë

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Nga ana e detyrimeve, **në tremujorin e katërt të vitit 2023** është arritur rritje tremujore prej 5,6 miliardë denarë ose 2,1%. Kjo rritje është kryesisht rezultat i kredive më të larta për 4,6 miliardë denarë, të cilat kanë edhe pjesëmarrjen më të madhe në strukturën e detyrimeve financiare të amvisërive.
- Në krahasim **me fundin e vitit 2022**, gjithsej detyrimet janë rritur për 18,7 miliardë denarë ose 7,5%. Rritja është rezultat i rritjes së kredive për 17,1 miliardë denarë dhe obligimeve tjera për 1,6 miliardë denarë.




Borxhi i sektorit “amvisëritë”

- **Borxhi i amvisërive** në fund të vitit 2023 arrin në 29.9% të PBB-së, që paraqet një rritje në krahasim me tremujorin e mëparshëm prej 0.5 p.p. Krahasuar me vitin paraprak, borxhi është rritur për 17,1 miliardë denarë ose 0,7 p.p. nga PBB.
- Nga pikëpamja sektoriale, huamarrja e amvisërive bazohet më së shumti në kreditë nga bankat, të cilat përbëjnë 91% të strukturës së borxhit, dhe një pjesë më e vogël është huamarrja nga jashtë dhe nga sektori ITJ.

Borxhi i amvisërive



Struktura e borxhit të amvisërive, sipas sektorëve







Sektori "Shteti"

- **Vlera financiare neto negative e shtetit** në tremujorin e fundit të vitit 2023 është 218,3 miliardë denarë dhe ka shënuar përkeqësim tremujor prej 19 miliardë denarë. Krahasuar me fundin e vitit 2022, vlera financiare neto negative është përkeqësuar për 35,4 miliardë denarë (19,3%).
- E analizuar sipas nënsektorëve, pozicioni negativ është më së shumti rezultat i nënsektorit "qeverisja qendrore", i cili ka një VFN negative prej 26.8% të PBB-së. Qeverisja lokale ka një pozicion financiar neto pozitiv prej 1%, ndërsa fondet sociale kanë një VFN negative prej 0.2% të PBB-së.

Mjete dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto






Sektori "Shteti"

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Në tremujorin e fundit të vitit 2023, totali i mjeteve të shtetit shënon rritje **tremujore** prej 6,5 miliardë denarë ose 2%. Kjo është kryesisht rezultat i rritjes së depozitave dhe rritjes së kapitalit, nga 3,7 miliardë denarë.
- **Në krahasim me fundin e vitit 2022**, gjithsej mjetet shënuan rritje prej 18,7 miliardë denarë ose 5,8%. Rritja është kryesisht për shkak të kërkesave të bazuara në kapital prej 12,9 miliardë denarë, pastaj rritjes së kërkesave të bazuara në letra me vlerë prej 2,6 miliardë denarë, parave të gatshme dhe depozitave për 1,9 miliardë denarë dhe kërkesave tjera për 1,8 miliardë denarë.




Sektori "Shteti"

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Nga ana e detyrimeve është shënuar rritje **tremujore** prej 25,4 miliardë denarë ose 4,8%. Rritja është më së shumti rezultat i rritjes së detyrimeve të bazuara në letra me vlerë të borxhit për 14,5 miliardë denarë dhe rritjes së detyrimeve nga kredite për 11,5 miliardë denarë.
- **Në krahasim me fundin e vitit 2022**, gjithsej detyrimet janë rritur për 54 miliardë denarë ose 10,8%. Rritja është kryesisht rezultat i rritjes së letrave me vlerë të borxhit për 46,2 miliardë denarë, kredive për 4,8 miliardë denarë dhe detyrimeve tjera për 3,5 miliardë denarë.




Sektori "Shoqëritë financiare" (SHF)

- **Vlera financiare neto** e shoqërive financiare në fund të vitit 2023 është negative dhe arrin në 6,5 miliardë denarë, që paraqet përkeqësim prej 6,8 miliardë denarë në krahasim me tremujorin paraprak. Vlera financiare neto është 0.8% e PBB-së, e cila paraqet një përkeqësim tremujor prej 0.7 p.p.
- E analizuar sipas nënsektorëve, përkeqësimi i pozicionit financiar neto të shoqërive financiare është rezultat i rritjes së pozicionit financiar neto negativ të bankave.

Mjete dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto (% e PBB-së)






Sektori "Shoqëritë financiare" (SHF)

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- **Në nivel tremujor,** totali i mjeteve të shoqërive financiare shënoi rritje prej 81 miliardë denarë, me shtytës kryesor të ndryshimeve paratë e gatshme dhe depozitat (69,4 miliardë denarë).
- **Në krahasim me fundin e vitit 2022,** gjithsej mjetet janë rritur për 128,2 miliardë denarë, si rezultat i rritjes së të gjitha instrumenteve, kryesisht parave të gatshme dhe depozitave (77,3 miliardë denarë), e më pas letrat me vlerë të borxhit (19 miliardë denarë), kredive (15,8 miliardë denarë) dhe kapitalit (11,7 miliardë denarë).




Sektori "Shoqëritë financiare" (SHF)

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të detyrimeve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Totali i detyrimeve shënon **rritje tremujore** prej 87,7 miliardë denarë, kryesisht si rezultat i rritjes së detyrimeve të bazuara në para të gatshme dhe depozita (67,7 miliardë denarë) dhe kapitalit (14,4 miliardë denarë).
- **Në krahasim me fundin e vitit të kaluar**, gjithsej detyrimet e shoqërive financiare janë rritur për 129 miliardë denarë, kryesisht si rezultat i rritjes së parave të gatshme dhe depozitave (75,7 miliardë denarë), e më pas edhe kapitalit dhe aksioneve/pjesëve të fondeve investuese. (35,2 miliardë denarë) dhe rezerva teknike të sigurimit (14,8 miliardë denarë).




Sektori "i huaj"

- Në fund të tremujorit të katërt, **pozicioni neto i sektorit "të huaj"** është pozitiv dhe arrin në 549 miliardë denarë, që paraqet rritje prej 26,8 miliardë denarë (5,1%) në krahasim me fundin e vitit të kaluar, gjegjësisht rritje prej 12,1 miliard denarë në krahasim me tremujorin paraprak. Ndryshimi i pozicionit pozitiv neto të sektorit "të huaj" rezulton nga rritja më e madhe e mjeteve financiare, në raport me detyrimet financiare.
- Në terma të treguesve relativë, pozicioni pozitiv neto është 65.3% e PBB-së, që paraqet një rritje prej 0.3 p.p. në raport me fundin e vitit 2022. Krahasuar me tremujorin paraprak, ai shënoi një rritje prej 1.4 p.p.

Mjete dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto e sektorit jashtë vendit






Sektori "i huaj"

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




➤ Në tremujorin e katërt të vitit 2023 është arritur rritje tremujore e **totalit të mjeteve financiare të sektorit të jashtëm** prej 21,9 miliardë denarë, përkatësisht 2,1%. Nga instrumentet, rritje tremujore është vërejtur te kreditë (23,4 miliardë denarë) dhe paratë e gatshme dhe depozitat (9,9 miliardë denarë), kundrejt zvogëlimit të kërkesave të tjera (15,3 miliardë denarë).

➤ **Krahasuar me fundin e vitit 2022**, është arritur rritje prej 73,3 miliardë denarë, përkatësisht 7,4%. Rritjen më të madhe e kanë kapitali dhe kreditë për rreth 32 miliardë denarë dhe letrat me vlerë të borxhit (13,1 miliardë denarë). Rënie është vërejtur te kërkesat e tjera (3 miliardë denarë).




Sektori "i huaj"

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



➤ Nga ana e **totalit të detyrimeve financiare**, është arritur rritje tremujore prej 9,8 miliardë denarë, gjegjësisht 1,9%, si rezultat i rritjes së detyrimeve të bazuara në para të gatshme dhe depozita (44 miliardë denarë), ndërsa detyrimet në bazë të kredive janë zvogëluar në 19,9 miliardë denarë dhe detyrimeve tjera në vlerë prej 14,3 miliardë denarë.

➤ **Krahasuar me fundin e vitit 2022**, është arritur rritje prej 46,5 miliardë denarë, që është një rritje prej 9,8%. Rritja është më së shumti reflektim i rritjes së detyrimeve të bazuara në para të gatshme dhe depozita (51,9 miliardë denarë) dhe kapital dhe aksione/pjesëve të fondeve investuese (11 miliardë denarë), kundrejt zvogëlimit të detyrimeve nga letrat me vlerë të borxhit (8,4 miliardë denarë) dhe kredive (7,6 miliardë denarë).